




Republika e Kosovës



Komuna e Istogut

PLANI INVESTIV NË INFRASTRUKTURËN E UJËSJELLËSIT DHE KANALIZIMIT NË KOMUNËN E ISTOGUT



HIDR DRINI



SHUKOS
SHKURTATA E UJËSJELLËSIV DHE KANALIZIMIT NË KOSOVË



USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE



International Relief & Development
Improving Lives. Building Livelihoods.



Maj 2011

Shkurtesat (akronimet):

- KK- Kuvendi Komunal,
- KRU- Kompania Regjionale e Ujsjellësit,
- SH.A- Shoqëri Aksionare,
- MPHM- Ministria e Planifikimit Hapsinor dhe Mjedisit,
- BE – Bashkimi European,
- GP- Grupi Punues.

Përmbajtja

Historiku i shkurter i Komunës.....	3
Pozita gjeografike	4
Pasuritë natyrore	5
1.0 Hyrje	
1.1 Sfondi	5
1.2. Roli dhe Përgjegjësitë e Komunës në Zhvillimin e Infrastrukturës Publike.....	5
Burimet kryesore.....	9
1.3. Gjendja Ekzistuese e Infrastrukturës së Ujësjetlësit.....	6
1.4. Arsyesheria e projekteve.....	12
1.5. Fazat e Implementimit.....	14
1.6 Çmimi për afërt dhe programi investiv në Ujësjetlësia.....	15
2.0 Gjendja Ekzistuese e Infrastrukturës së Kanalizimit	15
2.1 Problemet.....	17
2.2 Pasojat.....	18
2.3 Kanalizimi i ujërave të zeza – koncepti i zgjedhjes.....	18
2.4 Mos- funksionimet Kryesore.....	13
2.5 Opcionet e Rrjetit të Kanalizimit.....	23
2.6 Modelimi Hidraulik-Metodologjia.....	24
2. 7 Kostot e Planifikimit të Rehabilitimit dhe Zgjerimit të Rrjetit të Kanalizimit.....	24
3.0 Trajtimi i Ujërave të Zeza për Qytetin e Istogut (Krahësimi teknik-ekonomik dhe mjedisor si dhe zgjedhja e Opsioneve)	24
3.1 Alternativat e Trajtitit të Ujërave Urbane.....	24
3.2 Teknologjia e Implantit të Trajtitit të Ujërave urbane.....	25
3.3 Konkluzionet për alternativën 2.....	25
3.4 Përfitimet e projektit.....	29
4.0 Konkluzione dhe Rekomandime	30
Referencat	31

 Republika e Kosovës	KRYETARI		 Komuna e Istogut
	01 Nr.27/11	Data: 08.04.2011	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13. dhe nenit 17. pika f) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008), me qëllim të hartimit të planit investiv në infrastrukturë, bie këtë:

V E N D I M

- I. Formohet Grupi punues për hartimin planit investiv në infrastrukturë për ujësjellës dhe kanalizim dhe në grup caktohen:
 1. Bedri Hasanaj, Drejtor i Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, Kryesues;
 2. Qazim Loxha, Drejtor i Drejtoratit për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, anëtar;
 3. Rexhep Blakaj, Udhëheqës i sektorit të urbanizmit, anëtar;
 4. Sokol Berisha, Udhëheqës i sektorit shërbimeve publike dhe
 5. Elez Hajdaraj, nga kompania "Hidrodrini", anëtar.
- II. Grupi punues i cekur më lartë do të hartojë planin investiv në infrastrukturë për ujësjellës dhe kanalizim për tërë territorin e komunës së Istogut; do të njoftojë rregullisht Kryetarin më ecurinë e punëve rreth hartimit të planit investiv si dhe do t'i kryejë edhe punët të tjera që rrjedhin nga natyra e punës, rrethanat dhe kushtet momentale në teren.
- III. Grupi punues i cekur ka karakterin "ad hoc" dhe pas hartimit të planit investiv do t'i pushojnë të gjitha obligimet që rrjedhin nga ky Vendim.
- IV. Të gjitha punët juridiko-administrative dhe teknike për nevoja të grupit punues do t'i kryejë Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.
- V. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdesen: anëtarët e komisionit dhe Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.
- VI. Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: anëtarët e grupit punues, Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim dhe një kopje në arkivin e Zyrës së Kryetarit



Kryetari,
Haki Rugova

Historiku i shkurtër i Komunës

Në bazë të të dhënave arkeologjike, lokaliteti i Istogut përmendet dhe daton qysh nga koha antike, sipas disa burimeve historike thuhet se në pjesën e teritorit në mes të Istogut të madh dhe të vogël ku bashkohen lumi i Istogut dhe lumi i Qaushit. Ka ekzistuar një koloni romake gjë që i përket lokacionit të sotëm të qytetit, poashtu Istogu përmendet si lokacion edhe ka fundi I shek. XIV kur kjo pjesë e Dardanisë ishte nën pushtimin sllav. Gjatë kohës së sundimit turk, Istogu si vendbanim njifet me zhvillimin e mullinjëve për bluarjen e drithit si dhe punëtorive për perpunimin e leshit (zhgunit).

Me dekretligj nga 30 Prilli I vitit 1942 Istogu u shpall Qytezë, në rrethin e Istogut dhe krahas funksionit ekonomik të atëhershëm, Istogu në bazë të këtij dekretligji, fiton edhe funksionin administrativ. Me 29 Dhjetor të vitit 1978, Istogu shpallet Qytet me sipërfaqe të caktuar sipas planit urbanistik. Lokalitete të urbanizuara janë edhe Banja dhe Gurrakoci.



Pejsazh nga Qyteti i Istogut


Istogu në vitin 1935

Pozita gjeografike

Komuna e Istogut ka një pozitë të përshtatshme gjeografike dhe është e hapur në të gjitha anët me përjashtim të pjesës veriore e cila është e rrethuar me male të larta, Bjeshkë të thata dhe Mokna me një lartësi mbidetare deri në 2155 m (Mokna) dhe është e lidhur me rrugë të asfaltuara me të gjitha komunat e Kosovës.

Klima në këtë zonë ka karakter kontinental dhe karakter bregdetarë, por kryesisht dominon karakteri kontinental. Temperatura mesatare e vitit është rreth 10.7°C . Muaji më i ftohtë është muaji Janar me temperature mesatare -10°C . Lëvizja e ajrit ndikon në mënyrë të theksuar nga relievi, për këtë arsye shpejtësia e erës shpeshher arrinë gjerë në 120 km/h.

- Istogu shtrihet në anën veri-perëndimore të Kosovës dhe në pjesën veriore të Rrafshit të Dukagjinit
- Istogu kufizohet me këto komuna: Pejë, Klinë, Skenderaj, Zubin Potok, Tutinë (Serbi), Rozhajë (M.i Zi).
- Komuna e Istogut ka dhjetë bashkësi territoriale (vendbanime)
- Komuna e Istogut posedon sipërfaqe prej 454 km^2 , me një lartësi mbidetare 350-400m (fusha), ndersa lartësia më e madhe është 2155 m (Mokna).
- Me rexhistrimin e vitit 1981 Istogu kishte 50.011 banorë. Sipas vlerësimit në vitin 2007 vlerësohet të jenë 60.000 banorë, ku kryesisht dominon popullsia e moshës së re me një % të lartë.



Pasuritë natyrore

Komuna e Istogut është e pasur me begatit natyrore të cilat paraqesin bazë objektive për zhvillimin e përshpejtuar të kësaj treve. Begatinë sipërfaqësore e shënojnë sipërfaqet e tërësishme të tokës në një sipërfaqe prej 45.384 ha, ku prej tyre 22.879 ha janë tokë bujqësore, pyje janë 19.220 ha dhe të tjera 3285 ha. Teritori i komunës së Istogut është i pasur me ujëra sipërfaqësorë, nëntokësorë dhe termal. Komunën e Istogut e përshkojnë lumenjtë Drini i bardhë, lumi i Istogut, lumi i Vrellës, Kujafqi dhe Qaushi. Në Banjën Ilixha gjëndet uji termomineral me një kapacitet prej 17.5 l/sec dhe me një temperaturë prej 46° – 48° C ku janë të ngritura kapacitete për pushim dhe rekreacion që janë specializuar për shërimin e shumë sëmundjeve reumatike dhe sëmundjeve tjera të ndryshme. Pasuritë natyrore nëntokësore janë mermeri (Onix) në Banjë, i cili në kohën e tashme nuk eksploatohet më, si dhe thëngjilli (linjit) në fshatin Tuqep. Bujqësia është degë e zhvilluar në komunën e Istogut sepse këtë e mundëson kualiteti i mirë i tokës bujqësore si dhe mundësia e ujitjes së sipërfaqeve tokësore nga lumenjtë që e përshkojnë këtë territor. Komuna e Istogut posedon kushte të përshtatshme për kultivimin e peshkut, ku kryesisht kultivohet peshku (trofta e Kalifornisë), kapacitetet prodhuese të peshkut janë të ndërtuara në Istog dhe Vrellë.

V I Z I O N I

“Istogu do të jetë qytet I pastër dhe I këndshëm për jetesë, qytet i cili do të ndërtohet sipas planit modern urbanistik. Istogu do të ndërtoj një infrastrukturë të përshtatshme dhe do të krijojë kushte të mira për rritjen e shpejtë të biznesit privat dhe atë kryesisht në sektorin e bujqësisë, turizmit dhe prodhimit të peshkut. Qeveria lokale do të bashkëpunojë me sektorin privat dhe do të jetë shumë aktive dhe e inkuadruar drejt rritjes ekonomike, më qëllim të zvoglimit të nivelit të papunësisë dhe rritjes së standardit të jetesës për popullatën e Istogut.

1.0 Hyrje

1.1 Sfondi

Me iniciativën e USAID-it, respektivisht IRD dhe SHUKOS-it, me Kuvendin Komunal-Istog dhe KUR "Hidrodrini" Sh.A. ka marrë përsipër që të punojë në përgatitjen e një dokumenti përmbledhës për investimet e nevojshme në infrastrukturën e ujësjellësit, ujërave të zeza, në komunën e Istogut. Puna ka qenë ekipore e bazuar në parime të pjesëmarrjes aktive të të gjithë anëtarëve të grupit (Ujësjellësit dhe Kuvendit Komunal-Istog), me ç'rast angazhimet specifike të secilit anëtarë janë përcaktuar konform kualifikimeve përkatëse të tyre dhe eksperiencës profesionale.

1.2. Roli dhe Përgjegjësitë e Komunës në Zhvillimin e Infrastrukturës Publike

Menaxhimi i sistemit të ujësjellësit dhe ujërave të zeza në komunën e Istogut, bëhet nga Kompania Rajonale e Ujësjellësit „Hidrodrini“ e cila është e licensuar për këtë qëllim. Ndërkaq menaxhimi dhe mirëmbajtja e sistemit të kanalizimit të ujërave të shiut bëhet nga Komuna e Istogut përmes kontraktorëve të jashtëm.

Duke pasur parasyshë rëndësinë e infrastrukturës së ujësjetllësit, ujërave të zeza, dhe ujërave të shiut për kualitetin e jetës, mirëqënien e popullatës dhe për zhvillimin ekonomik dhe social të komunës, padyshim që komuna ka një rol të rëndësishëm në zhvillimin e kësaj infrastrukture. Kjo para së gjithash nënkupton interesin dhe përgjegjësinë e komunës për ofrimin e shërbimeve cilësore për pjesën e përfshirë të popullatës me këto shërbime, dhe po ashtu edhe për zgjerimin e infrastrukturës dhe krijimin e kushteve për përfshirjen e zonave aktualisht të pambuluara me shërbimet e ujësjetllësit dhe ujërave të zeza. Rrjedhimisht planet zhvillimore dhe urbanistike të komunës duhet të harmonizohen me planet e investimeve kapitale për rehabilitimin dhe zgjerimin infrastrukturës në territorin e saj administrativ.

Në këtë kontest, grupi punues, është udhëhequr nga parimi që projektet e ujësjetllësit dhe ujërave të zeza që janë përfshirë me këtë projekt-propozim të jenë rezultat i konsultimeve me KUR „Hidrodrini“ dhe të korrespondojnë me planet investive të kësaj kompanie duke qenë po ashtu në korelacion me planet zhvillimore të komunës së Istogut.

Në anën tjetër infrastruktura e kanalizimit të ujërave të shiut është përgjegjësi e drejtëpërdrejtë e Komunës, për të cilën nuk ekziston një kompani publike e as departament komunal i veçantë përgjegjës për menaxhim dhe mirëmbajtjen e saj. Si pasojë e saj mungojnë pasqyra e plotë e gjëndjes ekzistuese dhe projektet e planifikuara, kështu që GP (grupi punues) me rastin e hartimit të projekteve të propozuara për këtë infrastrukturë është bazuar në të dhënat nga K.K Istog dhe Kompania e Ujësjetllësit.


1.3 Gjëndja Ekzistuese e Infrastrukturës së Ujësjetllësit

Programi i infrastrukturës – Furnizimi me ujë dhe kanalizimi, synon rehabilitimin dhe rindërtimin e qëndrueshëm të infrastrukturës në Kosovë. Objektivi kryesor i projektit është krijimi i organizuar, teknik dhe financiar i shërbimeve komunale të ujit në bazë të principeve të ekonomisë së tregut.


Në kompanitë e ujit Hidrodrini në Njësinë e Istogut, ofrimi i shërbimeve konsumuese të besueshme sa i përket mbulimeve të shpenzimeve dhe të operimit të shërbimeve komunale si kompani efikase do të ilustruhet me shembuj. Ky raport merret vetëm me elementet e projektit që përqëndrohen në përcaktimin e vlerave në Istog. Raporti përfshinë rezultatet dhe përfundimet e studimeve në terren.


Sistemi i ujësjetllësit të Istogut e merr ujin nga burimi i Istogut, Javorit, Vojdullit, Vrellës, si dhe një pjesë e furnizimit bëhet nga burimi i Drinit të Bardhë. Kapaciteti i të gjitha burimeve është $Q = 20.380 \text{ m}^3/\text{ditë}$. Në tabelë janë paraqitur fshatrat të cilat shërbehen me ujë të pijshëm.





Burimi i Istogut, Penda







Gypi kryesor

Fshatrat-Belice, Kernine, Polane, Osojan, Kosh, Shalovice, Dreje,

Zallç, Zabllaq, Trubuhovc, Staradran, koshice, Dobrushe, Llukace I





Sistemi Ujësjiellës dhe burimeve

Burimet kryesore

Njësia e Istogut			
Nr.	Emri i burimeve	Kapaciteti-m ³ /ditë	l/s
1	Istogu	29,376	340
2	Javori	0.508	5.87
3	Vojdulli	0.827	9.57
4	Vrella	2,505	29

Gjatë muajve të verës shfaqen probleme në furnizim me ujë sidomos në pikat kritike të sistemit (zonat e larta dhe pikat e largëta). Arsyet kryesore për probleme të tilla konsistojnë në faktin se humbjet e ujit në sistemin e transmisionit dhe në sistemin distributiv janë në një shkallë jashtëzakonisht të lartë—rreth 60%. Këto humbje paraqesin ndryshimin ndërmjet sasisë së prodhuar dhe sasisë së faturuar të ujit. Pra ato përfshijnë humbjet komerciale dhe humbjet fizike/teknike. Proporcioni i këtyre dy kategorive të humbjeve nuk dihet saktësisht por vlerësohet të jetë 50%/50%. Faktorët kryesorë që ndikojnë në shkallën e lartë të humbjeve vlerësohet të jenë: (rrjeti i vjetruar i ujësjiellës, kyçjet ilegale, mos-matja e saktë e ujit).

Trajtimi i ujit të pijes bëhet me sistemin e dezinfektimit, në formën që në burimet e ujit ekzistojnë stacionet e klorimit ku klorohet uji konform standardeve të përcaktuara me dispozitat ligjore.


Sistemi i furnizimit me ujë është i ndarë në 2 zona: (I) zona e epërme, që furnizohet me ujë përmes sistemit të pompimit, dhe (II) zona e poshtme, që furnizohet me ujë me rrjedhje me gravitacion.

SRATEGJIA E INVESTIMEVE NË UJSJELLËS DHE KANALIZIM-KOMUNA E ISTOGUT

Nr	Vendbanimi	Komuna	Burimi - Emri	Nr. i Banorëve	Familje të furnizuara	Orët e furnizimit
1	Istog	Istogut	Istog	6756	1192	24
2	Istog i Poshtëm	Istogut	Istog	1550	255	24
3	Dushkajë	Istogut	Istog	500	90	16
4	Lluga	Istogut	Istog	887	143	24
5	Drogolevc i	Istogut	Istog	700	34	24
6	Serbobran	Istogut	Istog	290	47	16
7	Llukavci i Begut	Istogut	Istog	940	147	24
8	Muzhevinë	Istogut	Istog	1014	157	24
9	Tomoc	Istogut	Istog	2134	274	24
10	Gurakoc	Istogut	Istog	3769	685	24
11	Prekallë	Istogut	Istog	646	86	24
12	Drogolevc i epërm	Istogut	Istog	420	62	16
13	Dubravë	Istogut	Istog	1280	231	16
14	Bellopojë	Istogut	Javor	560	73	14
15	Uçë	Istogut	Javor	1653	213	12
16	Shushicë	Istogut	Javor	2110	398	16
17	Zhakovë	Istogut	Javor	594	95	16
18	Rakoshë	Istogut	Javor	1399	203	14
19	Vrellë	Istogut	Vrellë	3921	549	24
20	Stupe	Istogut	Vrellë	420	47	24
21	Temal	Istogut	Vrellë	612	47	24
22	Oroberdë	Istogut	Vrellë	810	134	24
23	Studenicë	Istogut	Vrellë	1952	292	24
24	Kaliqan	Istogut	Vrellë	1260	228	24
25	Dubovë e Vogël	Istogut	Drini i bardh	442	61	24
26	Bajicë	Istogut	Drini i bardh	904	89	24
27	Banjë	Istogut	Drini i bardh	1829	448	16
28	Llukavci i Thatë	Istogut	Istogut	247	34	12
29	Kovragë	Istogut	Istogut	1170	155	16
30	Dobrushë	Istogut	Istogut	1550	470	16
31	Kashicë	Istogut	Istogut	732	122	24
32	Saradran	Istogut	Istogut	2150	370	24
33	Trubuhoc	Istogut	Istogut	1260	212	24
34	Zabllaq	Istogut	Istogut	632	92	24
35	Zallq	Istogut	Istogut	720	144	24
36	Drejë	Istogut	Istogut	658	98	24
37	Shalnavicë	Istogut	Istogut	120	20	24
38	Osojan	Istogut	Istogut	260	116	24
39	Veriq	Istogut	Istogut	620	92	16
40	Lubov II	Istogut	Istogut	160	32	24
41	Prigodë	Istogut	Istogut	712	132	24
42	Cercë	Istogut	Istogut	1860	367	24
43	Lubozhdë	Istogut	Istogut	1250	249	16
44	Corrollukë	Istogut	Istogut	684	113	24
45	Oroberd II	Istogut	Istogut	510	85	24
46	Syne	Istogut	Istogut	530	104	12
47	Lubovë I	Istogut	Istogut	542	82	16
48	Gjithsejtë			55719	9369	

Në kuadër të furnizimit apo të prodhimit të ujit të pijshëm në Njësinë Operacionale në Istog janë këto asete:

- Tetë Depo (Rezervuare) të ujit me kapacitet 700m^3 , 400m^3 , 400m^3 , 800m^3 , 500m^3 , 200m^3 , 400m^3 , 400m^3 ,
- Katër stacione të pompimit,
- Pesë stacione të klorimit
- Një rrjetë prej 320 km të dimensioneve prej $\varnothing 50$ deri në $\varnothing 500$ gypsjellës të ujit.



Sistemi i Ujësjiellës, gjendja ekzistuese

Vendbanimet e furnizuara me Ujë nga sistemi i Ujësjiellës.

Vendbanimet të cilat duhet të furnizohen me ujë të sistemit.

1	Surigon	Istogut	Vazhdimësi	620	105	-
2	Cerkolez,	Istogut	Vazhdimësi	440	71	-
3	Keminë, I dhe II	Istogut	Vazhdimësi	780	98	-
4	Padalishtë.	Istogut	Vazhdimësi	612	92	-
5	Mojstirë	Istogut	Vazhdimësi	680	93	-
6	Gjithsejt			3132	459	

1.4Arsyeshmëria e projekteve

Emri i projektit:	Reduktimi i humbjeve teknike, projekti bazë i zgjerimit të rrjetit. (Implementimi i zonave të matura – DMA në rrjetin ekzistues)
Faza e Pare:	01
Lokacioni:	Projekti do të implementohet në zonën urbane të qytetit të Istogut
Kostoja:	Kostoja totale: 400,000€;
Përshkrim i shkurtër i projektit:	Sipas të dhënave të marra nga KUR "Hidrodrini" një kompani konsulente e përfshirë në një projekt të financuar nga KFW, me qëllim të zvogëlimit të humbjeve të ujit në kompanin e ujit, së bashku me stafin e Hidrodrinit, kanë projektuar krijimin e zonave të matura – DMA për zonat urbane të Istogut. Projekti përfshinë ndërtimin e 15 pusetave për ujëmatës zonal, me të gjitha fittingjet e nevojshme. Projekti do të implementohet në zonën urbane të qytetit të Istogut. Rreth 70% të klientëve të furnizuar nga Hidrodrini, njësia Istog, janë të koncentruar në zonën urbane të qytetit të Istogut. Kjo pjesë konsiderohet si pjesë e rrjetit me humbje më të larta të ujit në Hidrodrin, pasi që humbjet në këtë pjesë arrijnë vlerën prej 70%. Furnizimi total me ujë në zonën urbane të qytetit të Istogut është rreth 610.000m³/muaj. Duke u bazuar në shkallën e humbjeve të ujit prej 70%, aktualisht vetëm rreth afërsisht 160.000m³/muaj faturohet. Pas zvogëlimit të humbjeve dhe zgjerimit të shërbimeve të ujit, është e mundshme që të mbulohen investimet në një afat prej 6 muajsh.
Përfitimet:	Me zvogëlimin e humbjeve prej 70% në 40%, njësia e Hidrodrinit do të jetë në gjëndje që të kursej rreth 85,000m ³ /muaj ujë shtesë, duke mundësuar zgjerimin e shërbimeve të ujit në zonat tjera, në të cilat zona banorët vazhdojnë që të konsumojnë ujin nga pusët.
Emri i projektit:	Rehabilitimi i rrjetit të furnizimit me ujë për fshatrat e komunës së Istogut, rehabilitimi i sistemit të pompave kryesore të sistemit të ujit, si dhe shtimi i sasisë së ujit në burimet e Vojdullit dhe Moknës.
Faza e Dytë :	02
Kostoja:	Kostoja totale: 950.000 €,
Përshkrim i shkurtër i projektit:	Projekti përfshinë rehabilitimin e sistemit ekzistues të ujësjellësit të Istog-Gurakocit, Istog-Cerrcës, Lubozhdës, Prigodës, Istog-Kovragës, Veriqit, Dubravës dhe Synesë. Rehabilitimi i sistemit të pompave kryesore të sistemit të

SRATEGJIA E INVESTIMEVE NË UJSJELLËS DHE KANALIZIM-KOMUNA E ISTOGUT

	ujit, si dhe furnizimi dhe montimi i pompave për Banjë të Pejës dhe shtimi i sasisë së ujit në burimet e Vojdullit dhe Moknës. Bazuar në humbjet e ujit në rrjetin primarë dhe atë sekondarë, për shkak të vjetërsisë së gypave(gypat e azbestit dhe gypat e metalit) si dhe gabimeve teknike në disa sisteme të fshatrave të komunës së Istogut, është i domosdoshëm rehabilitimi i rrjetit të sistemit të ujit të pijshëm, si dhe kaptimi i dy burimeve, të Moknës dhe Vojdullit. Si dhe rehabilitimi apo zëvendësimi i pompave ekzistuese, për shkak të optimalizimit të energjisë elektrike, si dhe rritja e kapacitetit të disa pompave. Projekti do të implementohet në faza të caktuara si më poshtë, varesisht nga buxheti. Vetëm në qytetin e Istogut, pra në sistemin kryesor, duhet rehabilituar rrjetin e sistemit në 6 segmente: Rehabilitimi i gypit: • Ø 300, L=850m, Burim - Qendër. • Ø 250, L=1000m, Qendër – Istog i Poshtëm. • Ø 250, L=5000m, Istog i Poshtëm – Tomoc. • Ø 160, L=2150m, Qendër – Sheshi i Gjakut. • Ø 100, L=2300m, Zona e epërme-Bytyqi, Blakaj, Bujupaj. • Ø 110, L=200m, Centrali – ana e krahut të Spitalit. Nëpërmjet këtij projekti do të përfitojnë rreth 28.000 banorë, ose rreth 4.500 amvisëri.
Përfitimet:	Duke e rehabilituar rrjetin e furnizimit me ujë, shtimin e sasisë së ujit, si dhe rehabilitimin e pompave, njesia gjegjësisht kompania e ujit do të rrisë kualitetin e furnizimit me ujë, do të reduktoj humbjet e ujit si dhe do të reduktoj shpenzimet e mirëmbajtjes së rrjetit dhe reduktimet e shpenzimit të energjisë elektrike.
Emri i projektit:	Rrjeti i zgjerimit të furnizimit me ujë për fshatrat e komunës së Istogut.
Faza e Tret :	03
Kostoja:	Kostoja totale: 850.000 € ,
Përshkrim i	Projekti përfshinë ndërtimin e gypaconit të ri dhe ndërtimin e rrjetit të furnizimit

SRATEGJIA E INVESTIMEVE NË UJSJELLËS DHE KANALIZIM-KOMUNA E ISTOGUT

shkurtër i projektit:	me ujë, me diametra dhe gjatësi të ndryshme të gypit. Bazuar në politikat e Kuvendit Komunal të Istogut dhe Kompanisë së Hidrodrinit, ekziston sasi e mjaftueshme e ujit për të furnizuar këto fshatra. Rrjeti furnizues për këto fshatra do të kyçet në rrjetin ekzistues të sistemit apo në burimet alternative të ujit në burimet e Istogut i cili do të furnizohet përmes gravitetit apo të sistemit të pompimit. Projekti do të implementohet në fshatrat e komunës së Istogut: Surigon, Cerkolez, Kernin, Padalisht dhe Mojtir. Banorët e këtyre fshatrave janë duke u furnizuar me ujë nga pusët, të cilat sipas Institutit të Shëndetësisë Publike në Prishtinë, uji nuk i plotëson standardet e ujit të pijshëm, pasi që përmban ndotje bakteriologjike, duke paraqitur në këtë mënyrë rrezik për shëndetin e banorëve që jetojnë në këto fshatra. Mjaft shpesh në këto zona janë shfaqur edhe raste epidemiologjike. Nëpërmjet këtij projekti do të përfitojnë rreth 2.540 banorë, ose rreth 560 amvisëri.
Përfitimet:	Duke e zgjeruar rrjetin e furnizimit me ujë, kompania e ujit do të rrisë numrin e klientëve, dhe si rezultat do të rrisë të hyrat e veta, ndërsa në anën tjetër banorët do të furnizohen me ujë të pijshëm, ashtu që komuna do të përmbushë programin investiv të infrastrukturës së furnizimit me ujë.

Nevojat e rishikuara investive në vitin 2013

Emri i projektit	Përshkrimi	Viti i realizimit	Investitori	Njësia-Sasija	Kostoja në €
Ndërtimi i infrastrukturës ujsjellës, kanalizim, ujëra atmosferike në qendër të Istogut	Infrastruktura e vjetruar më se 40 vite dhe e pamjaftueshme për numrin e banorëve të tanishëm	2015-2017	Donatorë	2.5 km	2.000.000
Ndërtimi i kanalizimit dhe impiantit në fshatin Uqë -Rakosh	Përfitues direkt rreth 4.000 banor, të cilëkanë nevojë jetike për trajtimin e ujërave të zeza	2014-15	Donatorë	17 km	700.000
Ndërtimi i kanalizimit dhe impiantit në fshatin Cerrcë-Lubozhdë	Përfitues direkt rreth 2.500 banor, të cilëkanë nevojë jetike për trajtimin e ujërave të zeza	2014-15	Komuna-donator	14 km	350.000

SRATEGJIA E INVESTIMEVE NË UJSJELLËS DHE KANALIZIM-KOMUNA E ISTOGUT

Ndërtimi I ujsjellësit Burimi I Istogu- Bazeni Shushicë	Përforsim I domosdoshëm me pompim I furnizimit me ujë në 7 fshatra të anës lindore të komunës, sidomos në muaj e verës ku në këto fshatra ka mungesë të madhe të ujit të pijes.	2014-05	Komuna-donator	13 km	450.000
Ndërrimi I gypit të ujsjellësit të asbestit të ujsjellit të vjetër të Istogut	Ndërrimi I gypit të asbestit më se 40 vite I vjetër nga burimi Istogu deri në Tomoc	2015-16	Donatorë	8 km	1.200.000
Ndërtimi I ujsjellësit nga Burimi I Istogu deri në lubozhdë	Tani kjo pjesë e fshatrave Cerrcë, Lubozhdë, Prigodë furnizohet me ujë nga sistemi me pompa I cili është mjaft I kushtueshëm. Me gyp të ri të furnizimit mund të furnizohen me ramje të lirë pa e dëmtuar kualitetin e furnizimit dhe pa shpënzime të pompimit	2015-16	Donatorë	6 km	150.000

1.5Fazat e Implementimit

Programi i propozuar investiv për zgjerim të rrjetit si dhe reduktim të humbjeve ndahet në tri faza kryesore:

Faza 1: Implementimi i zonave të matura – DMA në rrjetin ekzistues, me 400.000 € , sigurimi dhe furnizimi me material, punët do ti implementoj KUR”Hidrodrini” – Pejë – Njësia Istog.
Faza 2: Rehabilitimin e sistemit ekzistues te ujësjellësit të Istogut, Lubozhdeës, Prigodës, Kovragës, Veriqit, Dubravës dhe Gurakocit, rehabilitimi i sistemit të pompave kryesore të sistemit të ujit si dhe furnizimi dhe montimi i pompave për Banjë të Pejës, si dhe kaptimi i burimeve te Moknës dhe Vojdullit. me 950.000 € , çmimi me hartim të projekteve Detale (viti 2012-2015).
Faza 3: Rrjeti i zgjerimit të furnizimit me ujë për fshatrat e komunës së Istogut. Me 850.000 € , çmimi me hartim të projekteve Detale (viti 2013).

1.6 Çmimi i përafërt dhe programi investiv në Ujësjiellës

Në bazë të vlerësimeve të kryera nga GP, për të ofruar një sistem të besueshëm të furnizimit me ujë të pijes çmimet e rehabilitimit dhe zgjerimit duhet llogaritur përafërsisht në vlerë prej afërsisht, 2.0 milion Euro. Kjo i përgjigjet investimeve specifike prej ~35 Euro për banorë.

Masat e vlerësuara, duke mbuluar periudhën deri më 2015, janë ndarë në 4 faza, duke përfshirë tërë kapacitetin e gjëndjes së furnizimit dhe mundësitë e shpenzimeve të sigurta operationale.

Fazat I.	Çmimi (Euro)
Faza 1 - Reduktim Implementimi i zonave të matura – DMA	400.000
Faza 3 – Rehabilitimi i pompave, pompat e reja për Banjë të Pejës si dhe shtimi i sasisë së ujit, si dhe rehabilitimi i sistemit, pompave dhe shtimi i sasisë së ujit	950.000
Faza 3 - Zgjerimi i fshatrave të mbetura.	850.000
Investimet për 3 Fazat	1.900.000
Inxhinieringu është i llogaritur	-
Shpenzimet e paparapara 5 %	70.000
Totali i Investimeve	2.270.000



Çmimet totale të rehabilitimit dhe zgjerimit të rrjetit të ujsjellësit

2.0 Gjendja Ekzistuese e Infrastrukturës së Kanalizimit

Sistemi i kanalizimit për qytetin e Istogut është ndërtuar në vitin 1972, 2004, 2008 në gjatësi 20.900 m, si sistem i tipit të ndarë: sistem i veçantë për largimin e ujërave të zeza nga sistemi i largimit të ujërave të shiut. Rrjeti i kanalizimit në Gurakoc të ujërave të zeza ka filluar të ndërtohet në vitin 1994, 2007 në gjatësi prej 17.200 m.

Problemet kryesore që kanë të bëjnë me rrjetin e kanalizimit të ujërave të zeza në komunën e Istogut, janë: (I) mos-përfshirja e disa zonave urbane të qytetit, (II) mos-përfshirja e zonave rurale, dhe (III) dimensionet jo-adekuate të rrjetit (si pasojë e rritjes së popullatës).

Harta e Kanalizimit i qytetit




Rrjeti

2.1 Problemet

- Mbledhja e pamjaftueshme e ujërave të zeza,
- Derdhja e ujërave të zeza pa trajtim,

Qyteti i Istogut ka vetëm rrjetin e kanalizimit fekal, përderisa mungon ai atmosferik. Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit është bërë pa ndonjë planifikim të mirëfilltë, varësisht prej nevojave të kohës dhe mjeteve materiale në dispozicion. Si pasojë është se dimensionet e gypave janë joadekuat dhe në shumë vende sjellin probleme të caktuara. Gjithashtu, edhe mirëmbajtja e rrjetit është shumë i vështirësuar. Vështirësi sjell edhe mospagesa e rregullt e qytetarëve për shërbime. Si në çdo vend në Kosovë edhe në këtë rast rol dominues në shpërndarjen e rrjetit të kanalizimit, ka luajtur konfiguracioni i terenit. Kështu të gjitha ujërat e zeza, pa përjashtim, shkarkohen në lumit e qytetit, në Istog. Shkatërrimi i ujërave të zeza bëhet pa ndonjë trajtim paraprakë duke e ndotur ujin e lumit. GP ka paraparë sistem të ndarë të kanalizimit, gjegjësisht një rrjet të kanalizimit fekal dhe një rrjet të kanalizimit atmosferik.



2.2 Pasojat

- Problemet mjedisore dhe sanitare të derdhjes së ujërave të zeza të pa trajtuara,
- Problemi sanitar i mbledhjes dhe largimit të pamjaftueshëm dhe joadekuat të ujërave të zeza,
- Përmbytjet e shpeshta në disa pjesë të qytetit.

2.3 Kanalizimi i ujërave të zeza – koncepti i zgjedhjes.

Projektet për rehabilitimin dhe zgjerimin e infrastrukturës së kanalizimit të ujërave të zeza janë ndarë në 2 nën-grupe:

- a) Rehabilitimi i rrjetit ekzistues të kanalizimit të ujërave të zeza dhe
- b) Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit të ujërave të zeza në zonat rurale

a) Rehabilitimi i rrjetit ekzistues të kanalizimit të ujërave të zeza

Rrjeti ekzistues i kanalizimit të ujërave të zeza është tejkaluar në kuptim të periudhës projektuese, meqënëse i njëjti është ndërtuar për periudhën projektuese deri në vitin 1990. Rrjedhimisht, dimensionet e tubacioneve të rrjetit janë joadekuate (të pamjaftueshme) për numrin aktual të popullatës së Istogut. Kjo ka për pasojë bllokimet e shpeshta të kolektorëve (pusetave) të kanalizimit dhe përmbytjet e rrugëve dhe pronave të qytetarëve.

Prandaj GP konsideron dhe rekomandon të bëhet modelimi hidraulik i rrjetit ekzistues që do të shërbente si bazë për ri-disejnimin e këtij rrjeti dhe hartimin e projektit zbatues që do të përmbushte nevojat e popullatës deri në vitin 2036.

Bazuar në konfiguracionin gjeografik të komunës së Istogut dhe në studimet për këtë çështje nga hartuesit të Planit Zhvillimor Komunal, na mundëson që sistemi i ujërave të kanalizimit të evuakohet (grumbullohet) me gravitet, në i kemi katër zona (pellgje) të grumbullimit. Grumbullimi i tëresishëm i ujërave të zeza pothuaj i tërë venbanimeve të KK-Istog do të përfundonin në fshatin Zabllaq ku parashihet trajtimi i tyre.


Ky është sipas GP prioritet i shkallës së I-ë sa i përket rrjetit të kanalizimit të ujërave të zeza dhe rekomandohet të finalizohet gjatë periudhës 2013-2016.

b) Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit të ujërave të zeza

Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit të ujërave të zeza në zonat urbane që aktualisht nuk janë të përfshira, e duke u bazuar në Planin Zhvillimor dhe Urban të Istogut është konstatuar nga GP si një prioritet i lartë dhe parakusht bazik për zhvillimin e Istogut.

Zona e Pare;

- Istog, Istog i Poashtem, Cercë, Lubozhdë, Mojstir, Syne, Dragolevc, Muzhevin, Llug, Prigod, Lukavc i begut, Kovragë, Tomoc, Gurakoc.



Projekti I - do të përfshijë qyteti dhe dhjetë (10) fshatra të cilët kanë gjithsej: **23,252** banorë (**31000** banorë - viti **2041**). Gjatësia e rrjetit primar (kolektori) është **33 km**, ndërsa gjatësia e rrjetit sekondar është: **30 km**. Diametri do të jetë minimal Ø 200 mm , ndërsa maksimal Ø 1000 mm, (7 km, nga Gurrakoci deri në Zabllaq), **tab. 1**.


Vlera financiare për realizimin e këtij pilot - projekti është : **4,800,000.00 Euro**.

Afati kohorë për realizimin e pilot - projektit fillimi 2012 - 2017.

Tab. 1. - Projekti I - Koha e implementimit (2012 - 2017)						
Nr.	Lokacioni	Nr. i ban. (2011)	Nr. i ban. (2041)	Rrj.primar (m)	Rrj. sekondar (m)	Kostoja (€)
1	Istog	6756	10000			Σ = 4,800,000.00 €
2	Cercë	1860	2500			
3	Lubozhdë	1250	1600			
4	Mojstir	680	1000			
5	Syne	530	700			
6	Istog i Posh.	1550	2000			
7	Muzhevinë	1014	1300			
8	Lluga	887	1200			
9	Prigodë	712	1000			
10	Tomoc	2134	2800			
11	Llukavc i B.	940	1200			
12	Kovragë	1170	1600			
13	Gurrakoc	3769	5000			
-	Totali	23,252	31900	33000	30000	

Zona e Dytë;

- Syrigonë, Cerkolez, Padalishtë, Uçë, Zhakovë, Shushicë, Rakosh, Bollopojë, Veriq, Dubravë, Kovragë, Llukavc i Thatë.



Projekti II - Koha e implementimit (2014 - 2019) do të përfshijë dymbëdhjetë (12) fshatra të cilët kanë gjithsej: 15074 banorë (21140 banor - 2041). Gjatësia e rrjetit primar (kolektorit) është: 28 km, ndërsa e rrjetit sekondar është: 23 km. Diametri do të jetë minimal Ø200 mm , ndërsa maksimal Ø 500 mm. **Tab.2.**

Vlera financiare për realizimin e këtij pilot - projekti është : 3,600,000.00 Euro.


Tab. 2. - Projekti II - Koha e implementimit (2014 - 2019)						
Nr.	Lokacioni	Nr. i ban. (2011)	Nr. i ban. (2041)	Rrj.primar (m)	Rrj. sekondar (m)	Kostoja (€)
1	Suhogerrlë	620	900			Σ = 3,600,000.00 €
2	Cerkolez	440	650			
3	Padalishtë	612	800			
4	Rakosh	1399	1700			
5	Shushicë	2110	2800			
6	Bollopoj	560	750			
7	Uçë	1653	2000			
8	Zhakovë	594	790			

SRATEGJIA E INVESTIMEVE NË UJSJELLËS DHE KANALIZIM-KOMUNA E ISTOGUT

9	Veriq	620	850			
10	kovragë	1170	1600			
11	Dubravë	1280	1900			
12	Llukavc i That	247	400			
13	Gurrakoc	3769	6000			
-	Totali	15,074	21140	28000	23000	

Zona e Tretë:

- Belicë, Kerninë, Tuçep, Veriq i Ri, Osojan, Polan, Kosh, Shalinovc, Drejë, Zallq, Zabllaq.



Projekti III - Faza e implementimit (2015 - 2020) do të përfshijë njëmbëdhjet (11) fshatra, të cilët kanë gjithsej 7200 banorë (10700 -viti 2039). Gjatësia e rrjetit primar (kolektorit) është **22 km**, ndërsa e rrjetit sekondar është **14 km**. Diametri do të jetë minimal Ø200 mm , ndërsa maksimal Ø 400 mm. **Tab. 3.**

Vlera financiare për realizimin e këtij pilot - projekti është : **2,800,000.00 Euro**.

Tab. 3. - Projekti III - Koha e implementimit (2015 - 2020)						
Nr.	Lokacioni	Nr. i ban. (2011)	Nr. i ban. (2041)	Rrj.primar (m)	Rrj. sekondar (m)	Kostoja (€)
1	Belicë	170	210			Σ = 2,800,00 0.00 €
2	Kerrninë	510	800			
3	Tyçep	120	150			

SRATEGJIA E INVESTIMEVE NË UJSJELLËS DHE KANALIZIM-KOMUNA E ISTOGUT

4	Veriq i ri	220	260		
5	Osojan	260	400		
6	Polanë	90	110		
7	Kosh	240	300		
8	Shalnavicë	120	160		
9	Drejë	658	900		
10	Zallq	720	1100		
11	Zabllaq	632	900		
-	Totali	3,740	5,290	22000	14000

Zona e Katërt:

- Vrellë, Studenicë, Kaliqan, Oroberdë, Lubovë, Bajë, Dubovë e Vogël, Bajicë, Corollukë, Dobrushë, Kashicë, Prekallë, Saradran, Trubohoc.



Projekti IV – Koha e implementimit (2012 – 2020)- do të përfshijë katërmëdhjet (14) fshatra të cilët kanë gjithsej: 19,362 banorë- (26,450 banor – 2041). Gjatësia e rrjetit primar (kolektorit)

SRATEGJIA E INVESTIMEVE NË UJSJELLËS DHE KANALIZIM-KOMUNA E ISTOGUT

është **35 km**, ndërsa gjatësia e rrjetit sekondar është **22 km**. Diametri do të jetë minimal $\varnothing$ 200 mm , ndërsa maksimal $\varnothing$ 600 mm. Tab. 4.

Vlera financiare për realizimin e këtij pilot - projekti është : **5,300,000.00 Euro**.

Tab. 4. - Projekti IV – Koha e implementimit (2012 – 2020)						
Nr.	Lokacioni	Nr. i ban. (2011)	Nr. i ban. (2041)	Rrj.primar (m)	Rrj. sekondar (m)	Kostoja (€)
1	Vrellë	3921	5200			$\Sigma = 5,300,000.00 \text{ €}$
2	Studenicë	1952	2500			
3	Kaliqan	1260	1800			
4	Orroberrë	1320	1850			
5	Lubovë	712	1000			
6	Banjë	1829	2600			
7	Dubovë e v.	442	650			
8	Baicë	904	1250			
9	Corrollukë	684	900			
10	Dobrushë	1550	2100			
11	Kashicë	732	1100			
12	Staradaran	2150	2900			
13	Trubuhovc	1260	1700			
14	Prekallë	646	900			
-	Totali	19,362	26,450	35000	22000	

2.4 Mos- funksionimet Kryesore

- Shumë pika derdhëse drejtëpërdrejtë (ose me trajtim të pjesëshëm) në lumin e Istogut,
- Mungesa e cilësisë të gypave dhe punimeve ndërtimore të ndërtuara para vitit 2000,
- Mungesa e konceptit të përgjithshëm zhvillimorë për kanalizim,
- Drenazhimi joadekuat i ujërave atmosferik,
- Mungesa e mirëmbajtjes (strukturat e drenazhimit te kanalizimit dhe ujërave atmosferike të bllokuara me materiale të ngurta),
- Kanalizime pjesërisht pa qasje,
- Nuk ka trajtim të ujërave të zeza.

2.5 Opcionet e Rrjetit të Kanalizimit

- Punimet e rehabilitimit të rrjetit të kanalizimit
 - Verifikimi i kapacitetit hidraulik të rrjetit të kanalizimit (modelimi hidraulik),
 - Vlerësimi i Punimeve Rehabilituese,

- Paralogaritë-Krahasimi i Opcioneve,
- Përmbledhja e Kostove Rehabilituese,
- Punimet e zgjerimit të rrjetit të kanalizimit.

2.6 Modelimi Hidraulik-Metodologjia

- Inçizimi gjeodezik i rrjetit primarë dhe rrjetit kryesor e sekondarë,
- Definimi i zonave ujëmbledhëse me konsiderim të hapësirave zgjeruese,
- Karakteristikat e zonave ujëmbledhëse: sipërfaqja, dendësia e popullsisë, koeficienti i pjerrësisë, shkalla e mbulesës së sipërfaqes,.....,
- Shtjellimi i modelit,
- Modelimi i kompjuterizuar hidraulik.

2.7 Kostot e Planifikimit të Rehabilitimit dhe Zgjerimit të Rrjetit të Kanalizimit

Planifikimi për Kanalizim FAZA II.	Kosto e Investimeve (Euro)
Totali për Rehabilitim	2.200.000
Projekti I	4,800,000
Projekti II	3,600,000
Projekti III	2,800,000
Projekti IV	5,300,000
Totali për Zgjerimit	16.500.000
Investimet totale:	18.700.000
Inxhinieria 5%	900.000
Shpenzimet e paparapara 5%	900.000
Totali i Investimeve në Kanalizim e Ujërave te Zeza, K.K - Istog	20.500.000

3.0 Trajtimi i ujërave të zeza për qytetin e Istogut (Krahasimi teknik-ekonomik dhe mjedisor si dhe zgjedhja e Opcioneve)

- Situatat ekzistuese e rrjetit të kanalizimit
- Pjesët përbërëse të studimit.
 - Prioritetet e Planit zhvillimor
 - Konkluzionet e projektit.
- Përfitimet e Projektit.

3.1 Alternativat e Trajtimit të Ujërave Urbane

- Asnjë eksperiencë me trajtimin e ujërave të zeza urbane, aktualisht në Kosovë.
- Vënia në zbatim me teknologjinë e lehtë të operimit (ekstensiv) të trajtimit në fazën e parë të zbatimit.
- Zgjedhje e teknologjisë së aprovuar dhe gjerësisht të përdorur.
- Synim në vazhdimësi në pajtim me kërkesat e BE.

3.2 Teknologjia e Impiantit të Trajtimit të Ujërave urbane,

Opsionet e Propozuara


Faza afatshkurtër – afatgjatë e zbatimit (2015)

- **Alternativa 1:** Pellgjet anaerobike të ndjekura nga laguna të ajrosura (kërkesa për tokë, 16 ha);
- **Alternativa 2:** Pellgjet anaerobike të ndjekura nga filtrat e me pikim (kërkesa për tokë, 11 ha);
- **Alternativa 3:** Trajtimi me llum aktiv dhe me ajrim të zgjatur (kërkesa për tokë, 6 ha);

Faza afatgjatë e zbatimit (2036)


- Trajtimi me llum aktiv, me tretje anaerobike të llumrave dhe largim të Azotit dhe Fosforit;

Alternativa 1: Pellgjet anaerobike të pasuara nga laguna të ajrosura (kërkesa për tokë, 20 ha, 2015)




Alternativa 2: Pellgjet anaerobike të ndjekura nga filtrat e me pikim (kërkesa për tokë, 15 ha, 2015)


SRATEGJIA E INVESTIMEVE NË UJSJELLËS DHE KANALIZIM-KOMUNA E ISTOGUT




Alternativa 3: Trajtimi me llum aktiv dhe me ajrim të zgjatur (kërkesa për tokë, 9 ha 2015)



SRATEGJIA E INVESTIMEVE NË UJSJELLËS DHE KANALIZIM-KOMUNA E ISTOGUT
Faza e zgjerimit në vitin 2036



Skema dhe foto për Alternativen 2.



Avantazhet e metodës trickling – filter (Alternativa 2)

- Kursim të energjisë.
- Volum të vogël.
- Sipërfaqe të vogël të tokës.
- Operim dhe mirëmbajtje të lehtë.

Parametrat e trajtimit të ujërave të zeza

Parametrat	Mg/l	Standarti
Ujrat e zeza të pa trajtuara BOD/SS Conc.	200/200 mg/L	
Ujrat e zaze të trajtuara BOD/SS Conc.	24/30 mg/L	Standarti EU. 25/35 mg/L
Popullsia	70.500 banorë	

Filtrat:



3.3 Konkluzionet për alternativën 2

- Është një projekt afatgjatë.
- Me shpërndarje të shpenzimeve kapitale në një periudhë të gjatë kohe.
- Vlera e përgjithshme e buxhetit duhet të caktohet.
- Parashikimi për ndërtimin e tubacionit të linjave kryesore dhe sekondare, me kolektorë kryesorë, stacione pompimi dhe impiant pastrimi.

3.4 Përfitimet e projektit

- Përpunimi i ujërave nga banesat e amvisëritë.
- Uji i ndotur, pas përpunimit fillestarë dhe dytësorë del në parametrat e kërkuara nga BE.
- Përmirësimi i cilësisë së ujit të Lumit të Istogut e në rrjedhë më tutje të Drinit.
- Përmirësimi i kushteve sanitare në qytet dhe brigjet e lumenjëve.
- Zvogëlimi i rrezikut të sëmundjeve dhe pasurimin e shëndetit njerëzor.
- Përmirësimi i imazhit të qytetit të Istogut.

Kosto e Impiantit për Trajtimin e Ujërave të Zeza

Përshkrimi	Njësia	Opcioni 2 ITUZ-2
Kapaciteti	p. e	70.500
Kostot Investive ITUZ	€	8.000.000
Kolektorët kryesorë	€	325.000
Investimeve	€	8.325.000
Inxhinierinë 5%	€	416.250
Shpenzimet e paparapara 3%	€	249.750
Totali i Investimeve për ITUZ	€	8.991.000
Kostot Specifike të Investimit	€ / p.e	~125

I. Infrastruktura e ujit të pijshëm

II. Infrastruktura e kanalizimit fekal**III. Trajtimi i ujërave të kanalizimeve urbane dhe rurale, Istog**

Pjesët	Përshkrimi	Çmimi (€)
I	Pjesa e Parë – Infrastruktura e Ujit të Pijshëm.	2.270.000
II	Pjesa e Dytë – Infrastruktura e Kanalizimit fekal.	20.500.000
III	Pjesa e Tretë – Trajtimit të Ujërave të Kanalizimeve Urbane.	8.991.000
Totali i Investimeve në Infrastrukturën e Ujit Kanalizimit dhe Trajtimit.		31.761.000

Totali për Infrastrukturën e Ujësjetës dhe Kanalizimeve është **31.761.000 Euro**, me një kosto specifike prej ~350 € / p.e (me kalkulim për 81.000 banor)

4.0 Konkluzione dhe Rekomandime

Infrastruktura e ujësjetës dhe kanalizimit në Komunën e Istogut është joadekuate si në kuptimin e cilësisë së saj po ashtu edhe në kuptimin e shtrirjes së pamjaftueshme të saj. Kjo situatë ka për pasojë shërbime jocilësore të popullatës me shërbimet vitale siç janë furnizimi me ujë dhe shërbimet e kanalizimit. Për më tepër një infrastrukturë e këtillë joadekuate dhe në rastin e kanalizimit të ujërave të shiut dhe impiantit të ujërave të zeza, mungesa e plotë e infrastrukturës ka pasojë mjedisore dhe sigurisht që paraqet pengesë për zhvillimin ekonomik dhe social të Komunës.

Ndikimet negative në ujëra janë kryesisht nga derdhjet e kanalizimeve të ujërave të zeza, të cilat nuk janë të trajtuara paraprakisht. Me planin e ri parashihet integrimi i infrastrukturës së kanalizimit të ujërave të zeza dhe ndarja e kanalizimit atmosferik, i cili mund të derdhet në lumenj. Po ashtu është paraparë ndërtimi i një impianti kryesor apo si alternativë – Impiant lokal, apo si nënstacion, para lidhjes së impiantit kryesor që parashihet të ndërtohet në Komunën e Pejës, varesisht në koordinim mes dy komunave, si dhe politikave institucionale, në këtë rast me Ministrin e Planifikimit Hapsinor dhe Mjedisit (MPHM).

Përveç eliminimit të ndotjes me mbeturina të shtretërve të lumenjëve, masat për mbrojtjen nga vërshimet kanë paraparë parandalimin e ndikimeve negative të rritjes së sasisë së ujit nëpër lumenjtë dhe përroskat e komunës së Istogut.

SRATEGJIA E INVESTIMEVE NË UJSJELLËS DHE KANALIZIM-KOMUNA E ISTOGUT

Komuna duhet të hartojë dhe nënshkruajë një marrëveshje mirëkuptimi me prodhuesit e peshkut, pasi që ujërat nga hurdhat derdhen në lumenj dhe ujërat e tilla ndotin ujin e lumenjëve. Matja e rregullt e sasisë së ndotjes do të mundësojë veprimet adekuate. Po ashtu komuna duhet t'i obligojë këta prodhues që ta mirëmbajnë sasinë e ujërave në kanalet e ujitjes prej nga furnizohen me ujë hurdhat e peshqve, për të mos e çënuar ujitjen e arave që është komponentë esenciale e prodhimtarisë së suksesshme bujqësore.

Prandaj është e nevojshme që institucionet përgjegjëse (Komuna e Istogut dhe KRU "Hidrodrini") të harmonizojnë veprimet e veta për planifikimin dhe për shqyrtimin e formave dhe mundësive për financimin e investimeve të cilat janë identifikuar dhe përpunuar me këtë dokument dhe të cilat GP i konsideron të domosdoshme për ndërtimin e një infrastrukture funksionale dhe cilësore të ujësjellësit dhe kanalizimit.

Duke pasur parasysh lartësinë e parallogaritur të investimeve në këtë infrastrukturë **31.761.000 Euro** dhe në anën tjetër kapacitetet financiare të limituara që ka Komuna dhe KRU "Hidrodrini", imponohet domosdoshmërisht eksplorimi i burimeve alternative të financimit të këtyre investimeve (donatorët, grantet nga Qeveria, buxheti i Komunës, mjetet e KRU "Hidrodrini", vetkontributi i qytetarëve etj.).

Rekomandohet që prioritetizimi i investimeve specifike në infrastrukturën e ujësjellësit dhe kanalizimit i propozuar me këtë dokument të shërbejë si një orientim për institucionet përgjegjëse për të hartuar një plan dinamik të implementimit të projekteve të veçanta duke i marrë në konsideratë burimet potenciale të financimit.

Vlerësim: Këto projekte të rëndësishme do të ndikojnë në jetën e banorëve në të ardhmen e afërt, por mund të kontribuojnë edhe në zhvillimin e përgjithshëm të komunës. Andaj, është e nevojshme që komuna dhe KRU "Hidrodrini" Sh. A., të jetë e kyçur aktivisht në procesin e planifikimit dhe implementimit të projekteve.

Ky dokument është hartuar, në bashkpunim me Grupin Punues (GP) të Kuvendit Komunal Istog në bashkëpunim me KRU "Hidrodrini" SH.A., si rezultat i vlerësimeve të gjendjes ekzistuese, hulumtimeve si dhe takimeve dhe punëtorive të njëpasnjëshme.

REFERENCAT

- Plani Zhvillimor Komunal dhe Urban – Istog,
- Strategjia e Kosovës për mjedisin – MPHM,
- Plani i Kosovës për veprim në mjedis 2010 – MPHM,
- Plani Hapësinor i Kosovës, Instituti për planifikim hapësinor MPHM,
- Të Dhenat e përgatitura nga KK Istog,
- Të Dhenat e përgatitura nga KRU "Hidrodrini" Sh.A.- Pejë.